



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 138 prot.

Kamëz, më 20.11 2023

V E N D I M

Nr. 95, datë 20.11.2023

PËR

MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN “PËRMIRËSIMI I
BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFRA DHE TË PA
FAVORIZUARA” PËR VITIN 2024

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.69 Datë 14.11.2023 Në zbatim të pikës 2, të nenit 24, germa "k" e nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015; "Për Vetëqeverisjen Vendore", referuar Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar; VKM-së nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore "; VKM-së nr. 454, datë 3.7.2019, “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”; Udhëzimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”; Këshilli Bashkiak Kamëz:

V E N D O S I :

1. Sistemin e pikëzimit për programin e Strehimit Social “*Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara*”.
2. Mënyra e vlerësimit dhe llogaritjes do të bëhet sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të ngarkojë Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Sektorin e Strehimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI